

---

## STATUTI

### I

#### SHOQERISE TREGTARE

#### "ASSA ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K.

Sot, më datë 06.12.2024 ortakët themelues:


- **Shoqëria Seman Sunpower SHPK**, person juridik Shqiptar, i regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër identifikimi NIPT K81722018P, me seli të regjistruar në adresën: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Murat Toptani, (Pedonalja e Tiranës), ndërtesa Eurocol përballë Kalasë së Tiranës, kati 7, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori zj. Irida Matlija, e bija e Sofikes dhe Meros, e datëlindjes 10.10.1977, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit elektronik me nr. Personal H76010137V.
- **Shoqëria Albanian General Electricity SHA**, person juridik Shqiptar, i regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër identifikimi NIPT L41706021V, me seli të regjistruar në adresën: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Murat Toptani" (Pedonalja e Tiranës), Ndërtesa e Eurocol, përballë "Kalasë së Tiranës", Kati i 7-të Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. Besar Llapashtica, i biri i Sadikut dhe Nerënxës, i datëlindjes 27.03.1990, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. personal J00327070S.
- **Shoqëria AGNA SHA**, person juridik Shqiptar, i regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër identifikimi NIPT J62903631L, me seli të regjistruar në adresën: Vrisera, Gjirokastër, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. Kristo Naçi, i biri i Spiro dhe Agllaia, i datëlindjes 28.04.1973, lindur në Vrisera, Gjirokastër, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me nr. personal H30428035Q.

vendosën themelimin e Shoqërisë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K., me termat si më poshtë:

#### I. PREMISA PARAPRAKE PËR THEMELUESIT DHE THEMELIMIN E SHOQËRISË

Bashkimi i përkohshëm i ortakëve të shoqërive themeluese, Shoqëria Seman Sunpower SHPK, Shoqëria Albanian General Electricity SHA dhe Shoqëria AGNA SHA, mori pjesë në procedurat konkurruese të hapura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zbatimin e projektit për "Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit/eve Fotovoltaike, secili me një kapacitet minimal të instaluar 10 MW (përfshirë) dhe që do të kërkojnë masa mbështetëse për të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të tyre të instaluar, ku

---



---

Kapaciteti i Mbështetur mund të jetë deri në 100 MW (përfshirë), me vendodhje në zonën Sheq Marina, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Bashkimi i përkohshëm i ortakëve të shoqërive themeluese, Shoqëria Seman Sunpower SHPK, Shoqëria Albanian General Electricity SHA dhe Shoqëria AGNA SHA, në përfundim të këtij procesi është shpallur fitues për ndërtimin e një parku fotovoltaiik me fuqi të instaluar prej 10 MW, siç është njoftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6119 prot., datë 23.07.2024 dhe sipas kontratës datë 25.11.2024, të lidhur midis palëve.

Duke qenë se ortakët themelues janë përgjegjës për firmosjen e kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për implementimin e projektit për ndërtimin e parkut fotovoltaiik me fuqi të instaluar prej 10 MW, në bazë të dokumenteve të tenderit kontratës me Nr. 9291 Prot, date 25.11.2024 të lidhur midis palëve, ata janë të vetëdijshëm që duhet të krijojnë një shoqëri tregtare sipas ligjislacionit tregtar me qëllim plotësimin e detyrimeve ligjore dhe realizimin e qëllimit ekonomik për të cilin do të krijohet kjo shoqëri.

## **II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **NENI 1 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- 1.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie:  
"Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaiik, me një kapacitet minimal të instaluar prej 10 MW, me vendodhje në Grykë Seman, Fier, në përputhje me kriteret dhe rregullat që rrjedhin nga detyrimet ligjore të përcaktuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të kontratës me Nr. 9291 Prot, date 25.11.2024. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji, në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi për implementimin e parkut fotovoltaiik 10 MW. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës, në funksion të realizimit të projektit për Parkun Fotovoltaiik 10 MW".

### **NENI 2 - EMRI DHE SELIA E SHOQËRISË**

- 2.1 Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "**ASSA ENERGY SOLUTIONS**" SH.P.K
- 2.2 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: "*Sheq Marinas, ZK3358, Pasuria me Nr. 558/1- ND, Fier. Shqipëri*".

### **NENI 3 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË.**

- 3.1 Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

### **NENI 4 - REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar, atij civil në fuqi dhe legjislacionit përkatës në fushën e energjisë së rinovueshme.

---



- 4.2 Me vendim të Asamblese së Pergjitheshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mesipërme. Shoqëria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

### **III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE.**

#### **NENI 5.**


- 5.1 Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë, përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.
- 5.2 Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng ose hipotekë me miratimin e Ortakëve.

#### **NENI 6 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE.**

- 6.1 Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një të dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili, në rast se do t'u përhapej personave të paautorizuar, do t'u shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.
- 6.2 Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut, në ligj dhe në përcaktimet e kontratës së datës 25.11.2024, të lidhur midis palëve, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik, me një kapacitet minimal të instaluar 10 MW, me vendodhje në Grykë Seman, Fier. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.
- 6.3 Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime dhe trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

#### **NENI 7 - ABUZIMI I ORTAKËVE NDAJ SHOQËRISË**

- 7.1 Ortakët e shoqërisë tregtare që kryejnë një ose më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:



- 
- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
  - b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
  - c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitalet e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.



## **NENI 8 - NDALIMI I KONKURENCËS**

- 8.1 Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor. Ndalimi i përmendur më sipër mund të ndryshohet apo shfuqizohet përmes një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga Asambleja e Përgjithshme me 51% të votave. Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
- 8.2 Nëse ndonjë prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
  - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
  - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmti.
- 8.3 Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmti, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:
  - të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
  - t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e krediteve që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

## **NENI 9 - LARGIMI I ORTAKUT NGA SHOQËRIA DHE LIKUIDIMI I KUOTËS**

- 9.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme, apo për shkak të tjerë që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshëm.
- 9.2 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshëm, nëse pas njoftimit të largimit, Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

---



- 
- 9.3 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

#### **NENI 10 - PËRJASHTIMI I ORTAKUT**

- 10.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut, ose nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit, ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
- 10.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
  - me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
  - përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
  - me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
- 10.3 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
- 10.4 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet që kanë sjellë përjashtimin.
- 10.5 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
- 10.6 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblimin e dëmit, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumën që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **IV. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**

##### **NENI 11 - AKTIVITETI I SHOQËRISË**

- 11.1 Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë dhe të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

---



---

## NENI 12 - KAPITALI FILLESTAR

- 12.1 Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasitë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.
- 12.2 Ortakët mund të kryejnë, në bazë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, financime për llogari të shoqërisë në përpjesëtim me kuotat e zotëruara në kapital, mbulimin e humbjeve, ashtu si edhe për financime jo fitimprurëse.

## NENI 13 - KAPITALI I SHOQËRISË

- 13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i Ortakëve Themelues dhe është në vlerën totale 10 000 000 Lekë (dhjete milion lekë). Ai përbëhet nga 3 (tre) kuota.
- 13.2 Ortakët themelues do të zotërojnë kuotën e tyre në Shoqërinë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" SH.P.K., si më poshtë:
- **Shoqëria Seman Sunpower SHPK**, në cilësinë e njërit prej Ortakëve Themelues, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 40% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë totale prej 4 000 000 Lekë (katër milion).
  - **Shoqëria Albanian General Electricity SHA**, në cilësinë e njërit prej Ortakëve Themelues, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 20% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë totale prej 2 000 000 Lekë (dy milion).
  - **Shoqëria AGNA SHA**, në cilësinë e njërit prej Ortakëve Themelues, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 40% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë totale prej 4 000 000 Lekë (katër milion).
- 13.3 Kapitali themeltar është derdhur në total nga ortakët themelues në ditën e sotme. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortakët me miratimin e këtij Akti.

## NENI 14 - PRONËSIA MBI KUOTAT

- 14.1 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - shit-blerjes;
  - trashëgimisë;
  - dhurimit;
  - në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

## NENI 15 - MIRATIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME PËR FITIMIN APO KALIMIN E KUOTAVE

- 15.1 Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

---



- 
- 15.2 Ortaku që kërkon të shesë plotësisht apo pjesërisht kuotat zotëruese të kapitalit në Shoqërinë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k., iu drejtohet shkresërisht, me letër rekomande ose e-mail, secilit prej ortakëve të Shoqërisë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k., përmes së cilës iu ofron për blerje kuotat që kërkon të shesë.
- 15.3 Ortakët ekzistues të Shoqërisë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k., brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga marrja e shkresës ose e-mailit së dërguar nga ortaku që ofron për shitje kuotat, kanë detyrimin t'i kthejnë përgjigje shkresërisht me letër rekomande ose edhe e-mail ortakut ofrues, nëse pranojnë ose nuk pranojnë të blejnë kuotat e ofruara për blerje.
- 15.4 Në rast se ortakët nuk kthejnë përgjigje shkresërisht, me letër rekomande ose email brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga marrja e shkresës/e-mailit, qoftë nga njëri ose nga secili prej ortakëve të tjerë ekzistues të Shoqërisë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k., nga dita e nesërme ditës së 45-të (dyzet e pesë), ortaku që kërkon të shesë kuotat është i lirë t'ia shesë ato çdo personi të tretë, jo ortak, që ai do ta konsiderojë të arsyeshëm, qoftë ky individ, person fizik ose person juridik. Çmimi i shitjes së kuotave kundrejt personave të tretë, jo ortakë, jashtë shoqërisë, në asnjë rast nuk do të jetë më i ulët se çmimi që iu është ofruar ortakëve ekzistues brenda shoqërisë.

#### **NENI 16 - ANULIMI I KUOTËS**

- 16.1 Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e tyre.
- 16.2 Rastet e anulimit të kuotës do të përcaktohen nga rregulla të posaçme, të miratuara nga Asambleja e Ortakëve me 51% të votave. Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij statuti.


#### **NENI 17 - ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 17.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave.
- 17.2 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë, duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.
- 17.3 Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.
- 17.4 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimin të kapitalit. Në të kundërt, Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

#### **NENI 18 - FONDET REZERVË**

- 18.1 Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

---



---

## **NENI 19 - PËRDORIMI I TË ARDHURAVE NETO**

- 19.1 E ardhura neto që rezulton pasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti, zbritja e vlerës së amortizimit, tatimet dhe taksat, kuotat që rritin kredinë për investime, pagat dhe shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

## **NENI 20 - BILANCI, PLANI FINANCIAR**

- 20.1 Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj, sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve, në momentin e themelimit të Shoqërisë.
- 20.2 Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.
- 20.3 Plani financiar parashikon aktivin dhe pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

## **NENI 21 - SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

- 21.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

## **NENI 22 - KUFIZIMI I SHPËRNDARJEVE TË FITIMEVE**

- 22.1 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 22.2 Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 22.3 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht para shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
- 22.4 Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividende, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

---



---

## V. ORGANET E SHOQËRISË.

### NENI 23 - ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

23.1 Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave në rastet e mëposhtme:

- a) Ndryshimet e statutit;
- b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
- c) Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
- d) Shpërndarja e fitimeve;
- e) Raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti.

23.2 Për rastet e tjera, ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, si më poshtë:

- a) Miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- b) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- c) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- d) Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve;
- e) Emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) Përcaktimi i shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- g) Mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- i) Pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j) Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

### NENI 24.

24.1 Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- 1) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 2) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 4) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme të shoqërisë.

24.2 Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 më sipër, para Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

---



- 
- 24.3 Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 më sipër, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### **NENI 25 - THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

- 25.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë para datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 25.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 26 - KUORUMI I NEVOJSHËM DHE VENDIM-MARRJA**

- 26.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmë e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 26.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 26.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 26.4 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët që nuk janë të pranishëm kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
- 26.5 Ortaku që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmshpërblimit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

#### **NENI 27 - PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË**

- 27.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 27.2 Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbalëve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

---

27.3 Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

27.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

#### **NENI 28 - HETIMET E POSAÇME**

28.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë gjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

28.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Në të kundërt, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga Asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.


28.3 E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

28.4 Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rënda të ligjit apo statutit.

28.5 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme, apo secili kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të procedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi i Asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

28.6 Proçedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçëm i shoqërisë, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditërët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime lidhur me përfaqësimin e tij jo në interes të shoqërisë.

28.7 Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.



- 
- 30.2 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padi të që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **NENI 31 - SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE**

- 31.1 Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme. Shpërblimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 31.2 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
- 31.3 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **NENI 32 - EKSPERTËT KONTABËL**

- 32.1 Shoqëria emëron ekspertin kontabël për një afat njëvjeçar në rastet e parashikuara nga ligji. Emerimi i tyre bëhet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 32.2 Ekspertët kontabël janë përgjegjës për mirëmbajtjen e dokumentave të shoqërisë. Ata janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara që mund të vijë nga mbajtja e llogarive në mënyrë të parregullt.
- 32.3 Nuk mund të emërohen si ekspertë, themelues, administratore, apo persona që kanë lidhje gjaku deri në shkallën e katërt.

## **VII. MARRËDHËNIET E PUNËS.**

### **NENI 33 - MARRËDHËNIET E PUNËS**

- 33.1 Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
- 33.2 Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë dhe të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë dhe sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

### **NENI 34 - PËRGJEGJËSIA PËR DËMET**

- 34.1 Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

---

### **NENI 37 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUIDUESVE**

- 37.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarketuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rendin e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
- 37.2 Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit dhe t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

### **NENI 38 - BILANCET**

- 38.1 Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### **NENI 39 - SHPËRNDARJA E AKTIVEVE**

- 39.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve asetet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon rend të preferencës. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli, u kthehen ortakëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

### **NENI 40 - LIKUIDIMI I THJESHTËSUAR**

- 40.1 Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer dhe janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
- 40.2 Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtësuar.
- 40.3 Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtësuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

---

## VIII. PRISHJA E SHOQERISË. LIKUJDIMI.

### NENI 35 - PRISHJA E SHOQERISË

35.1 Shoqëria priset në rastet kur:

- Kur mbaron kohezgjatja e themelimit të saj;
- Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- Në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkak të arsyeve të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- Në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- Për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve, etj.

35.2 Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratoret.

### NENI 36 - Likuidimi i Shoqërisë

36.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

36.2 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

36.3 Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

36.4 Gjykata emëron likuiduesin në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

36.5 Administratoret e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë gjithashtu Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

36.6 Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

---



---

## VI. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 29 - ADMINISTRATORI

- 29.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtërirjeje.
- 29.2 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të caktojë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.
- 29.3 Administrator i Shoqërisë për një periudhë 3 (tre) vjetecare emërohet:  
Z. Marjol Çala, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, Shqipëri, më 08.05.1983, mbajtës i pasaportës me Nr. BD2015462 dhe Nr. personal I30508084Q, me banim në Fier, Shqipëri. Afati i emërimit nis nga data e regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 29.4 Shoqëria do të përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët e shoqërisë, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### NENI 30 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

- 30.1 Administratorët kanë të drejta dhe detyrime për të:
- Kryer të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Përfaqësuar shoqërinë tregtare;
  - Kujdesur për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - Përgatitur dhe nënshkruar bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - Krijuar një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbijetesën e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - Kryer regjistrimet dhe dërguar të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - Raportuar para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - Kryer detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
  - Thirrur Asamblenë e Përgjithshme kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, dhe kur, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuara brenda 3 muajve në vazhdim.

## IX. DISPOZITA TË FUNDIT.

### NENI 41

41.1 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### NENI 42

42.1 Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### NENI 43


43.1 Ky Statut përpilohet në 3 kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me nga 16 (1-16) fletë secila kopje dhe, pasi lexohen, nënshkruhen pa vërejtje nga ortakët themelues.

### ORTAKËT THEMELUES:

**Shoqëria "Seman Sunpower" sh.p.k**

Përfaqësuar nga Administratorja

Znj. Irida Matlija


**Shoqëria "AGNA" sh.a**

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Kristo Naçi


**Shoqëria "Albanian General Electricity" sh.a**

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Besar Llapashtica

